



TRAJNIM PËR 91 STUDENTË PRANË KLINIKAVE TË LIGJIT

Vazhdojmë të bashkëpunojmë me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë. Për 91 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit u mbajt trajnimi *"Garantimi i ndihmës juridike parësore nga klinikat Ligjore dhe studentët"*.

Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z.Ergys Qirici mori pjesë në tryezën e punës me aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtare për fillimin e hartimit të *"Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030"* mbajtur nga Ministri i Drejtësisë.



Vlorë

QSHNJP Vlorë realizoi një takim në terren në kuadër të *"Ditës ndërkombëtare të gruas"* lidhur me mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave të tyre, si dhe u shpërndan fletëpalosje të shoqëruara edhe me lule.



Përmet

Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z.Ergys Qirici mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Përmet, si një nga Qendrat e hapura si pasojë e implementimit të hartës së re gjyqësore dhe garantimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi.



Pukë

Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z.Ergys Qirici mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pukë, si një nga Qendrat e hapura si pasojë e implementimit të hartës së re gjyqësore dhe garantimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi.





QSHNJP Vlorë, mori pjese ne takimin e organizuar nga AFD, me temë "Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes rritjes së aksesit në të drejtat ekonomike, ligjore dhe sociale".



QSHNJP Durrës dhe Kavajë zhvilluan në datën 20.03.2024, një takim me Drejtorinë Rajonale Durrës të Shërbimit Social Shtetëror, si strukturë e krijuar zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin.



QSHNJP Durrës dhe Kavajë zhvilluan në datën 22.03.2024, një takim pranë ambienteve të Komisarariatit të Policisë Durrës me Inspektoren e Krimit ndaj të miturve dhe dhunës në familje Znj. Etleva Kastrati.



QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 19.03.2024, në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimit të Klientit dhe Departamentit të Ankesave pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, një takim ndërgjegjësues dhe informues.



QSHNJP Kavajë zhvilloi në datën 13.03.2024 , një takim me Qendren e Shërbimit Social Kavajë. Qëllimi i takimit ishte të rrisë kapacitetet e bashkëpunimit ndërmjet dy Qendrave sa i përket rasteve të referimit të personave me pamundësi ekonomike dhe shtresave vulnerabel.



QSHNJP Tropojë mori pjesë në datën 01.03.2024, në takimin e organizuar nga Unicef dhe Bashkia Tropojë mbi trafikimin e qenieve njerëzore.




QSHNJP Tropojë Në kuadër të edukimit ligjor të grave dhe vajzave, në datën 31.03.2024, organizoi një takim me vajza dhe gra të fshatit Jaho Salihi.

QSHNJP Dibër mori pjesë në trajnimin e datës 20.02.2024 organizuar nga Bashkia Dibër, me një grup nxënësish të gjimnazit "Sehit Najdeni", Peshkopi.



QSHNJP Fier në datën 25.03.2024 zhvilloi një aktivitet në Shoqatën e të Verbërve Fier, referuar dhe nenit 11, të ligjit Nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", pika dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit.



QSHNJP Kurbin zhvilloi një aktivitet në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese, informuesedhe mbështetese me komunitetin Egjiptian, të Bashkisë Kurbin.

QSHNJP Lezhë mori pjesë në datën 28.03.2024 në tryezën e organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë dhe me mbështetjen e Kryetarit z. Pjerin Ndreu, për promovimin e Ligjit të Ri të Arbitrazhit. U diskutua për përfitimet e ligjit të ri dhe rëndësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë sistemit gjyqësor.



QSHNJP Lezhë mori pjesë në datën 12.03.2024 në takimin e organizuar nga Bashkia Lezhë, Organizata Jofitimprurëse "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", ku ishin të pranishëm përfaqësues të UNDP dhe ADA në Shqipëri.




QSHNJP Lezhë mori pjesë në datën 21.03.2024 në prezantimin e projektit "Hapat drejt Ringritjes" nga Fondacioni "Mary Ward Loreto", të financuar nga Bashkia Lezhë, i cili ka në fokus fuqizimin e grave dhe vajzave të dhunuara/viktimat e mundshme të trafikimit. Në takim ishin të gjithë aktorët që bashkëpunojnë me shërbimin social në mbështetjen e grave dhe vajzave me problematika të ndryshme sociale.



QSHNJP Lushnjë mori pjesë në datën 04.03.2024, në një aktivitet të organizuar nga Bashkia Lushnjë, në bashkëpunim me qendrën "Strehëza Edlira Haxhiymeri dhe U.N.Women". Tema e takimit: "Adresimi me efektivitet i rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore - Kuadri Ligjor i Ndryshuar".

QSHNJP Mat në datën 05.03.2024, zhvilloi dy takime. Një takim në Njësinë Administrative Suç dhe një në Qendrën Shëndetësore Suç. Takimet konsistuan në promovimin e Qendrës dhe bashkëpunimin institucional.



QSHNJP Mat në datën 13.03.2024, zhvilloi një takim me qëllim sensibilizimin, informimin dhe parandalimin e dhunës kundër grave. Tema e takimit ishte: "Gruaja dhe dhuna ndaj saj".

QSHNJP Pukë në datën 11.03.2024, me ftesë të kordinatorëve të Bashkisë Pukë zj.Lavdie Terbuni dhe Melita Kuç dhe me prezencë të përfaqësuesve të UNDP organizuam një bashkëbisedim me temat të dhunës në familje dhe trafikimet si fenomene shoqerore dhe mundësia që ofron QSHNJP Puke në lidhje me shërbimet ligjore për kategoritë e parashikuara nga Ligji Nr.111/2017 'Për ndihmë juridike të garantuar nga shteti'



QSHNJP Gjirokastrë mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të "Javës Kundër Diskriminimit", me pjesëmarrjen e Komisionerit z. Gajda, përfaqësues nga UV "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe student.